



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
29.04.2024**

Me datë 29.04.2024, u mbajt mbledhja e këshillit bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Uarda Gjekaj, Jona Leqeja, Edmond Ndou, Hilmi Lakti, Bledianë Nika, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkoçaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Gëzim Galiqi, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Florian Bjanku, Irena Shala, Elmira Ndërvashaj, Gjenarin Kapcari, Irma Kopliku, Elis Doci, Valjeta Bajraktari, Ardit Behri, Eliona Shkreli, Aleksander Pashuku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Violeta Perndrecaj, Gjovalin Ndoj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Erkan Hoxha, Marina Duhani, Gloria Shllaku, Muharrem Shkjau.

Kourumi i domosdoshëm është i pranishëm në sallë, mbledhja deklarohet e hapur.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit Z. Oltion Luli

Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. Pr/ Vendim: *"Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Znj. Anita Amuli".*
2. Pr/ Vendim: *"Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Z. Fatmir Vojvoda".*
3. Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2024".*
4. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar. (Bashkefinancim)*
5. Pr/ Vendim: *"Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 e miratuar me VKB. Nr.55 datë: 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër. (Emergjencat Civile)*
6. Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar. (Rialokim)*

7. Pr/ Vendim: "Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen".
8. Pr/ Vendim: "Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2024".
9. Pr/ Vendim: "Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2025-2027.
10. Pr/ Vendim: "Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Shkodër".
11. Pr/ Vendim: "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër".
12. Pr/ Vendim: "Për miratimin e planit "Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2024".
13. Pr/ Vendim: "Për miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të ekonomisë pyjore "Lugina e Kirit", Njësia administrative Pult, ngastra 189b, me sipërfaqe 250 m², me afat 5-vjeçar, për vendosjen e antenave të komunikimit të kompanisë të telefonisë celulare "One Albania sh.a".
14. Pr/Vendim: "Për dhënien në përdorim të pasurisë prej 140.42 ha ndodhur në Ekonominë pyjore "Drin Gjadër Kir" parcela 004, 010, z.k 1690 nr. Pasurie 888, për një periudhë 10 vjeçare për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhim energjie".
15. Pr/ Vendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".
16. Pr/ Vendim: "Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Shkodër".
17. Diskutime jashtë rendit të ditës.

Përpara se të hidhet në votim rendi i ditës fjalën e merr Z.Bjanku i cili shprehet se rendi i ditës përmban 4 pika lidhur me ndryshime e shtesa në buxhetin e Bashkisë Shkodër, ndërkohë që kjo kërkon një procedurë të veçantë. Po ashtu edhe pika 14, kërkon konsultim publik.

Sqaron këtu Z.Luli, duke thënë se mbështetur në ligjin 139, fishat e buxhetit janë rezultat i konsultimeve publike. Prandaj çdo gjë është sipas procedurës së kërkuar.

Hidhet në votim rendi i ditës, ku rezultojnë **29 Pro 10 Kundër 0 Abstenim. Miratohet**

Vijohet me pikën e parë të rendit të ditës: Pr/ Vendim: "Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Znj.Anita Amuli".

Po ashtu edhe me pikën 2. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Z. Fatmir Vojvoda"*.

Duke qënë se këto dy pika janë të njëjta, relaton nga ana e Komisionit të mandateve **Znj.Gjckaj**, duke u shprehur se komisioni ka shqyrtuar dokumentacionet përkatëse dhe nuk kemi papajtueshmëri prandaj mund të kalojmë për votim të dyja kandidaturat.

Kalohet në votimin e pr/aktit të parë: Pr/ Vendim: *"Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Znj.Anita Amuli"*, ku rezultojnë **39** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Hidhet në votim edhe pr/akti i dytë: *"Për plotësimin e vakancës dhe dhënien e mandatit të anëtarit të Këshillit bashkiak Z. Fatmir Vojvoda"*, ku rezultojnë **39** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me leximin e formulës së betimit nga ana e Kryetarit të Këshillit dhe Znj.Amuli dhe Z.Vojvoda kryejnë betimin.

Kalohet në pikën 3. të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Mars 2024"*.Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **42** vota Pro, **0** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e radhës , Pr/ Vendim: *"Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar. (Bashkefinancim).*

Relaton për pr/vendimin **Z.Mema**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr Znj.Shala e cila kërkon të dijë se si është bërë përzgjedhja e shkollave , ku do ndërhyhet dhe a mund të kemi më shumë detaje rreth projekteve të paraqitura.

Sqaron **Z.Beci**, duke thënë se ndërhyrja do kryhet tek ato shkolla që e kanë më të nevojshme dhe shpërndarja është bërë e drejtë. Ai nuk beson se detajet e projektit në këtë rast janë të rëndësishme.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë **31** vota Pro, **10** Kundër, **0** Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 5.të rendit të ditës: pr/ Vendim: *"Për një shtesë në buxhetin e vitit 2024 e miratuar me VKB. Nr.55 datë:29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër.(Emergjencat Civile)*

Relaton për pr/vendimin në fjalë **Z.Lazri**, këshilltar pranë kabinetit të Kryetarit të bashkisë sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Z.I.Sokoli**, i cili kërkon të dijë më shumë për shpenzimet që parashikon ky pr/akt. Ai shton se nuk e sheh të nevojshme të blihen asete por shërbime.

Përsëri sqaron **Z.Beci**, duke thënë se shuma e ofruar është shumë e vogël dhe nuk mund të flasim për blerje asetesh apo shërbimesh. Këto për më tepër janë parë dhe studiuar nga ekspertë të fushës.

Znj.Pode shpreh mbështetjen e saj dhe përgëzon për punën e bërë, pasi shton ajo kërkesa të tilla kanë dalë nga konsultimet publike.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, kurse Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD nuk shprehin dakortësi.

Pr/akti hidhet në votim , ku rezultojnë 29 vota Pro, 12 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pr.vendim nr.6: Pr/ Vendim: *"Për një ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar. (Rialokim)*

Relaton në mënyrë të detajuar për pr/aktin **Znj.Haxhi**, drejtore buxheti në Bashkinë Shkodër, po ashtu edhe drejtorët e drejtorive përkatëse lidhur me projektet e drejtorive tyre, sipas materialeve të përgatitura nga administrata.

Znj.Shkrela merr fjalën dhe shprehet se nuk po shihet zgjidhje për qentë e rrugës me strehezat që po marrin kaq shumë shpenzime.

Përgjigjet **Zv/kryetari Z.Beka**, duke thënë se ky është një problem me shumë impakt por ai beson që përmirësimi i situatës është i dukshëm në këtë drejtim. Dhe po që strehezat kanë qënë ndihmesë e madhe për qentë duke patur parasysh këtu edhe animalizmin.

Znj.Bajraktari kërkon të dijë më detajisht lidhur me efincën e pastrit të kanaleve që u fol më sipër dhe për ngrohjen në shkolla.

Përgjigjet **Z.Salihi** nga administrata duke thënë se përse i përket pastrimit të kanaleve, mjeti që do blihet do mund të pastrojë aty ku forca punëtore nuk mundet, prandaj themi që do rritet efienca.

Po ashtu lidhur me ngrohjen në shkolla sqaron **Z.Kulla** duke thë se të gjitha shkollat parashikohen të kenë ngrohje me kaldajë.

Vijojnë me pyetje lidhur me detaje për pr/aktin **Z.Sokoli** dhe **Znj.Kopliku**.

Sqaron këtu **Z.Beci** duke thënë se kemi një shtim buxheti sot për Bashkinë Shkodër prej 3 Milion \$, shumë që përkthehet në 70% investime të drejtëpërdrejta, të ndara më së miri në të gjitha drejtimet dhe investime këto aty ku ka më së shumti nevojë, për plotësimin e kërkesave të dala nga dëgjesat publike. Ai gjithashtu shton se për të mirën e qytetit dhe shërbimet e shyara që do vijnë nuk është e nevojshme të merremi me detajet.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, kurse Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD nuk shprehin dakortësi.

Pr/akti nr.6 "*Për një ndryshim në VKB nr.55 datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar. (Rialokim) hidhet në votim , ku rezultojnë 28 vota Pro, 13 Kundër, 0 Abstenim.*

Miratohet

Kalohet tek pika 7. e rendit të ditës: Pr/ Vendim: "*Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen".*

Relaton për këtë pikë **Znj.Kruja**, drejtore e drejtorisë së Shërbimit social pranë Bashkisë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr përsëri **Znj.Shala**, e cila kërkon të dijë se sa persona janë përfitues nga ky projekt duke parë shumën e përfituar nga ai.

Përgjigjet **Znj.Kruja**, duke thënë se nga ky projekt përfitojnë 60 fëmijë dhe 60 të rritur përfshirë këtu pjesën e after school, kampet verore dhe klasat e prindërimit.

Z.Sokoli përgëzon për nismën dhe shton se ky projekt vjen në ndihmë të dy zonave më problematike të qytetit dhe fton këshilltarët ta votojnë.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD shprehin dakortësi.

Pr/akti nr.7 "*Për një shtesë plani dhe ndryshim në buxhetin e bashkisë Shkodër për projektin "Fuqizimi i komunitetit përmes ofrimit të shërbimeve ditore të alternuara për fëmijët dhe familjen", hidhet në votim , ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.*

Miratohet

Kalohet tek pika 8. e rendit të ditës: Pr/ Vendim: "*Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2024".*

Relaton përsëri **Znj.Kruja**, drejtore e drejtorisë së Shërbimit social pranë Bashkisë Shkodër, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, edhe Znj.Shala për grupin BF dhe Z.I.Sokoli për grupin PD shprehin dakortësi.

Pr/akti nr.8: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2024"*, hidhet në votim , ku rezultojnë 30 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 9.të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2025-2027.*

Relaton për këtë pr/akt **Znj.Haxhi**, drejtore e dr.Buxhetit, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shala merr fjalën përsëri dhe kërkon të dijë pse kemi një rritje vetëm prej 2%, kur dimë që kemi tashmë rritje taksash dhe tarifash. Po ashtu ajo thotë se ne lidhje me tokën bujqësore, ka 1% tatim të thjeshtuar, në një kohë kur kjo është shfryqizuar me ligj, ku është e pasqyruar kjo në materialin e paraqitur?

Përgjigjet **Znj.Haxhi** duke thënë se 2% është marr si një mesatare e 3 viteve, kurse 1% i tokës bujqësore është si detyrim i prapambetur.

Fjalën e merr **Z.Galiqi** i cili shprehet se vërën një trend rritës të të ardhura në buxhetin e Bashkisë Shkodër dhe përgëzon për këtë dhe shton gjithashtu se duhet patjetër të gjinden mënyra të reja zhvillimi dhe investimi.

Pr/akti nr.9: Pr/ Vendim: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të vlerësimeve dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave të bashkisë së Shkodrës për vitet 2025-2027,*hidhet në votim , ku rezultojnë 29 vota Pro, 8 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet tek pika 10. e rendit të ditës: Pr/ Vendim: *"Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Shkodër"*.

Relaton përsëri për pr/akt **Znj.Haxhi**, drejtore e dr.Buxhetit, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Shala përsëri thotë se kemi depozituar një kërkesë lidhur me këtë pr/akt dhe do donim të kishim një përgjigje.

Përgjigjet në mënyrë të detajuar **Znj.Haxhi**, duke cituar materialin e përgatitur dhe sqaruar pikat kyqe të tij.

Z.Bjanku për procedurën shprehet se ligji mbi të drejtën e informimit ka një afat 10 ditor, që të njihemi me materialin e paraqitur. Dhe tani nuk duhej të mjaftoheshim me një përmbledhje të tij.

Znj.Shllaku merr fjalën dhe kërkon të dijë nëse ka filluar veprimtarinë shoqëria "Bio Strajca" dhe nga kush administrohet. Dhe për çfarë janë përdorur 15 Milion lek që keni vendosur fakt në realizimin e buxhetit. Së dyti, nga FSHZH-ja keni reklamuar se janë kryer

disa ndërhyrje në infrastrukturë. Pse nuk janë paraqitur se sa ka përfituar Bashkia nga secili objekt?

Përgjigjet **Z.Mema** në lidhje me Bio Strajcën, duke thënë se Shoqërisë i janë kaluar me VKB 10 milion lek dhe jo 15 milion. Funksionimi i saj ka filluar, po merremi me strukturimin e saj dhe së shpejti do kalojë në administrimin e kësaj shoqërie edhe tregu i Rusit.

Z.Dibra përgjigjet në lidhje me pyetjen tjetër duke thënë se çdo ndërhyrje është bërë e mirëmunduar duke menduar edhe për shqetësimet e qytetarëve për telat e internetit. Kurse në lidhje me pyetjen mbi FSHZH-në përgjigjet **Znj.Haxhi** duke thënë se Bashkia është vetëm përfituese dhe citon këtu shifrat konkrete.

Tjetër pyetje vjen nga **Znj.Kopliku**, e cila kërkon të dijë për rikonstruksionin e rrjetit të ujësjellësit dhe ndërtimin e rrjetit të brendshëm në fshatrat Kullaj, Guci, Shtoj i Ri, i Vjetër dhe Vinoteka, pse ky investim nuk ka asnjë lek realizim këtë vit dhe cilat janë pengesat për përfundimin e tij?

Përgjigjet përsëri **Znj.Haxhi**, e cila sqaron se fondi për ndërtimin e këtij rrjeti është dhënë nga Bashkia Shkodër dhe mendojmë që brenda 2024 do jetë i përfunduar.

Ndërhyn këtu **Z.Luli** duke thënë se pyetjet teknike dhe specifike duhet të trajtohen në komisionet përkatëse, komisione këtë të pambajtura për mungesë kourumi.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, Znj.Shala për grupin BF shprehet kundër, edhe Z.I.Sokoli për grupin PD shprehet kundër.

Pr/akti nr.10 : Pr/ Vendim: *“Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Shkodër”*, hidhet në votim , ku rezultojnë 24 vota Pro, 11 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet ne pikën tjetër të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër”*.

Relaton edhe për pr/vendim **Znj.Haxhi**, drejtore e dr.Buxhetit, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, Znj.Shala për grupin BF shprehet kundër, kurse Z.I.Sokoli për grupin PD shprehet dakordësi.

Pr/akti nr.11: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për Bashkinë Shkodër, ”*, hidhet në votim , ku rezultojnë 26 vota Pro, 6 Kundër, 1 Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 12 të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e planit “Për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në Bashkinë Shkodër për vitin 2024”.*

Relaton shkurtimisht **Znj.Aida Shllaku**, drejtore në drejtorinë e Mjedisit në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Sokoli kërkon të dijë nëse kemi një inventar pyjesh dhe cilat janë projektet që ndërmerr ky plan?

Përgjigjet mbi këtë **Znj.Shllaku**, duke thënë se në materialin e paraqitur mund të gjeni konkretisht shumën e ofruar dhe kemi çdo gjë të inventarizuar, saktësisht kemi 10 ekonomi pyjore. Aktualisht Bashkia Shkodër me fondet e veta realizon planin e mbarështimit.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Të gjithë kryetarët janë pro këtij pr/vendimi.

Pr/akti nr.12, hidhet në votim, ku rezultojnë 35 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën 13. Pr/ Vendim: *“Për miratimin e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të ekonomisë pyjore “Lugina e Kirit”, Njësia administrative Pult, ngastra 189b, me sipërfaqe 250 m², me afat 5-vjeçar, për vendosjen e antenave të komunikimit të kompanisë të telefonisë celulare “One Albania sh.a”.*

Relaton përsëri **Znj.Aida Shllaku**, drejtore në drejtorinë e Mjedisit në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Të gjithë kryetarët janë pro këtij pr/vendimi.

Pr/akti nr.13, hidhet në votim, ku rezultojnë 34 vota Pro, 1 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën e radhes, pika nr.14 e rendit të ditës: Pr/Vendim: *“Për dhënien në përdorim të pasurisë prej 140.42 ha ndodhur në Ekonominë pyjore “Drin Gjadër Kir” parcela 004, 010, zk 1690 nr. Pasurie 888, për një periudhë 10 vjeçare për vendosje stacionesh, bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhim energjie”.*

Relaton përsëri **Znj.Aida Shllaku**, drejtore në drejtorinë e Mjedisit në Bashkinë Shkodër sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Z.Bjanku merr fjalën dhe shprehet se ky pr/akt ka mangësi në paraqitjen e tij nga ana procedurale dhe kërkon më shumë kohë për shqyrtim.

Përgjigjet këtu **Znj.Shllaku** duke thënë se sot kërkohet vetëm miratimi në parim i këtij pr/akt, pasi këto mund të quhet investitor strategjik dhe marrëdhëniet janë të rregulluara me ligj gjithsesi. Patjetër që në vazhdim do pajiset me klauzola të tjera.

Z.Pashuku kërkon të dijë se çfarë përfiton komuniteti i zonës në këtë rast dhe a ka nevojë ky pr/akt për dëgjuesë publike?

Përsëri **Znj.Shllaku** shprehet se në materialin teknik bashkangjitur gjeni të gjitha përgjigjet tuaja, kurse në lidhje me dëgjuesën, ajo bëhet vetëm në rast tjetërsimi prone dhe ligji në rast dhënie me qira nuk e kërkon dicka të tillë.

Znj.Pode shprehet pozitivisht nismave të tilla, që të shërbejnë në zhvillimin e njësive administrative.

Kalohet tek mendimet e kryetarëve të grupeve politike. Në emër të grupit të PS, Z.Ndou shprehet pro Pr.Vendimit, në emër të grupit të PSD Z.Sokoli po ashtu shprehet dakort miratimit të Pr.vendimit, Znj.Shala për grupin BF shprehet kundër, edhe Z.I.Sokoli për grupin PD shprehet kundër.

Pr/akti nr.14, hidhet në votim, ku rezultojnë 27 vota Pro, 10 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Vijohet me pikën 15: Pr/ Vendim: *“Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”*.

Hidhet në votim ky pr/vendim, ku rezultojnë 37 vota Pro, 0 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në pikën e fundit të rendit të ditës: Pr/ Vendim: *“Për miratimin e Programit të Transparencës në Bashkinë Shkodër”*.

Relaton mbi këtë pr/akt **Znj.Leqejza**, drejtore juridike në Bashkinë Shkodër sipas materialit të paraqitur.

Pyetje e diskutime nuk ka. Hidhet në votim ky pr/vendim, ku rezultojnë 33 vota Pro, 0 Kundër, 1 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në miratimin e dorëheqjes së Z.Denis Lesha, sekretar i Këshillit bashkiak , ku rezultojnë 31 vota Pro, 3 Kundër, 0 Abstenim.

Miratohet

Kalohet në *Diskutime jashtë rendit të ditës*.

Znj.Pode merr fjalën përsëri dhe i bën thirrje kolegëve këshilltarë, që duhet t'i marrin më me seriozitet mbledhjet e komisioneve, me qëllim që aty të trajtojmë çdo kërkesë dhe pyetje teknike ose specifike.

Znj.Shala kërkon që semafori në kryqëzimin kryesor, të programohet pak më shumë për këmbësorët, pasi po krijohen shpesh herë probleme.

Edhe **Z.Bjanku** shpreh një shqetësim të banorëve të Thethit, pasi kanë probleme me ndriçimin në zonë. Ai kërkon që të shihet ky problem dhe ti jepet zgjidhje pasi në sezonin turistik kjo do kishte impakt jo të mirë.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

Kryetari i Këshillit e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së këshillit bashkiak Shkodër të datës 29.04.2024. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 10 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

Sekretar

Denis LESH

Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

KRYETAR

